




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria për Kulturë në Komunën e Prishtinës
duke u mbështetur në Vendimin për Kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve
nr. 01-091-112404 të dt. 12.05.2014, u bën

THIRRJE

krijuesve, producentëve dhe shtëpive filmike të aplikojnë me projekt propozime për realizimin e projekteve FILMIKE. Përkrahja financiare u jepet projekteve të papërfunduara të të gjitha zhanreve. Të interesuarit duhet të përmbushin kriteret si në vijim:

- Të plotësojnë dhe dorëzojnë të nënshkruar formularin për aplikim, i cili mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës;
- Të dorëzojnë një kopje të sinopsis-it dhe skenarit të titullit konkurrues;
- Të prezantojnë dëshminë për të drejtën e autorit (Deklarata e autorit);
- Të paraqesin informatat teknike si: kohëzgjatja, teknika, regjia, aktorët, etj.;
- Të prezantojnë dëshmi për sigurimin e 40% të fondeve të planifikuara;
- Të përfundojnë realizimin e projektit deri me 30 qershor 2017;
- Të dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara në formularin për aplikim.

Projekt propozimet mund të dorëzohen në zyrën pritëse, sporteli nr.5 në Komunën e Prishtinës (objekti i vjetër) deri më **20 shkurt 2017**.

Formulari për aplikim mund të shkarkohet vegzën: <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Kultures,Rinise,Sportit/Subvencionet/Subvencione/Formularet-per-aplikim.aspx>

VËREJTE: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës si dhe projektet e palëve të cilët nuk kanë përmbyllur projektet nga fazat paraprake nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Për çdo informatë shtesë ju lutem na shkruani në kultura.pr@rks-gov.net